



Republika e Kosovës
 Republikë e Kosovës
 Qeveria - Vlada - Government
 Komuna e Drenasit
 Drenas
 Zyra e Prokurimit
 611-21-1734-5-8/C410
 KONTRATË/FURNIZIM/



Emri i Projektit: Marrëveshje kornizë Furnizim me pemë dhe perime

Numri identifikues: 611-21-033-111R, Date: 15.04.2021; Nr. i arkivit: 400-15939

PALËT NË MARRËVESHJE

KOMUNA E DRENASIT - DRENAS, përfaqësuar nga MENSUR GILAREVA, Zyrtar i Prokurimit (me tujë "Punëdhënësi"),
 "Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.SH. SKAND - IN ; DONI PRODUCT SH.P.K. " , përfaqësuar nga FISNIK NEZIRI, Drejtor (me tujë kontraktuese).

NENI I LIGJI I APLIKUESHËM

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për gëshjet që nuk mbulojnë me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Jurisdiksioni do të jetë gjykatë përkatëse në Prishtinë.

NENI 2 LËNDA

Lënda e kontratës duhet të jetë : Marrëveshje kornizë Furnizim me pemë dhe perime

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar.

2.1 Vendi i pranimi të punëve/shërbimeve / furnizimeve do të jetë: Komuna e Drenasit, Inkonteri i zbatueshëm do të jetë DDP. Periudha e kryesë se punëve/shërbimeve dhe furnizimeve do të jetë në afatin prej : 6 muaj

NENI 3 ÇMIMI

Çmimi i furnizimeve është në shumën prej: 3 151,20€ me fjalë (TRE MIJE E NJE QIND E PESHEDHJETË E NJE E 20 CENT).

3.1 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka bërë Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bërës përkatëse)

3.2 Pagesat do të bëhen në pagtim me Kushtet e kontratës.

NENI 4 PAGESAT

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet kur të raporton Komisioni për pranim, duke mos e tejkaluar shumën prej: 3 151,20€

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën dëbitorët i llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3 Komisionin për pranim i caktojnë Njësitë Kërkuuese. Afati i kryerjes së punëve/shërbimeve/furnizimeve duhet të jetë brenda 10 ditëve. Pranimi duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV,

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë parafjalim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dëshon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i parqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 10 Nën-kontraktimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialët, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përpunimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialët dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilin ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuar deri në një maksimum prej 10% të vlerës totale të kontratës.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

6.1 Kualiteti i furnizimeve/shërbimeve/punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 6 Kualiteti

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në gimin e kontratës.

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

a) Menaxher apo Mbikqyrës nuk mund të caktohet personi i cili ka marrë pjesë në hartimin e paramasave ose specifikimeve dhe as Ai që ka marrë pjesë në vlerësimin e ofertave. Menaxheri i projektit duhet të veprojë konform Udhëzimit A01, përkatesisht Neni 61.

b) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat me të domosdoshme për pagesë në Theasar nga Menaxheri apo Zyrtari ndërlidhës. Përqindja % e pagesës, të punëve/shërbimeve dhe furnizimeve të kryera do të caktohet nga Drejtoria për Arsim..Poashtu zyrtari ndërlidhës dokumentacionin duhet ta përcjellë për pagesë. Çdo faturë duhet të pranohet nëpërmes arkivit nga Drejtoria për Arsim.

c) Të gjitha dokumentet si: akvendimet, procesverbalet, raportet për punë/shërbimeve/ furnizime të kryera, faturat, shkresat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari ndërlidhës i Mjesise kërkuese.

d) Zyrtari ndërlidhës dhe arkivin të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimi, urdhërit për pagesë dhe urdhërblertjes, t'i arkivoj dhe ruaj dhe një kopje ti sjellë në ZP.Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'u ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

Neni 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurim Publik *Ligji* Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe dokumentacionit dytësor. Monitorimin e kësaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen Drejtoria për



| | | | |
|-----------------------------|--------------------------------|-------------------|--------------------|
| Për Autoritetin Kontraktues | | Për Kontraktuesin | |
| Emri: | MENSUR GLLARËVA | Emri: | FISNIK NEZIRI |
| Pozita: | Zyrtar përgjegjës i prokurimit | Pozita: | Drejtor |
| Nenshkrimi: | <i>[Signature]</i> | Nenshkrimi: | <i>[Signature]</i> |
| Data: | 16.04.2021 | Data: | 16.04.2021 |
| Vula: | | Vula: | |

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Pjesë e ofertës është pararamasa dhe paralogaria e ofertuesit. Kontrata hynë në fuqi me 16.04.2021

Neni 14 Komunikimi

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në një pajtim me ligjin e Kosovës, Juridiksioni do të jetë gjykatë përkatëse në Prishtinë.

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës midësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka parafunduar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërprese kontratën nëse Autoriteti Kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjyqimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës.